


Menaxhimi i mbetjeve urbane në zonat turistike



Sugjerime për bashkinë e Shkodrës për të hartuar kontatat e pastrimit për njësitë administrative Velipojë dhe Dajç

LISTA E TABELAVE	2
LISTA E FIGURAVE	2
HYRJE	3
1. MENAXHIMI I MBETJEVE NË NJA VELIPOJË DHE DAJC	3
1.1 QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE KUFIZIMET E STUDIMIT	3
1.2 GJENDJA EKZISTUESE E MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË NJA VELIPOJË	4
1.2.1 <i>Organizimi i shërbimit</i>	4
1.2.2 <i>Prodhimi i mbetjeve</i>	4
1.2.3 <i>Grumbullimi dhe transporti</i>	5
1.2.4 <i>Depozitimi i mbetjeve</i>	5
1.3 GJENDJA EKZISTUESE E MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË NJA DAJC.....	5
1.3.1 <i>Organizimi i shërbimit</i>	5
1.3.2 <i>Prodhimi i mbetjeve</i>	6
1.3.3 <i>Grumbullimi dhe transporti</i>	6
1.3.4 <i>Depozitimi i mbetjeve</i>	6
2. VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE VELIPOJË DHE DAJC	6
2.1 INDIKATORËT E CILËSISË SË SHËRBIMIT.....	7
2.1.1 <i>Indikatori C1: Eficenca në grumbullimin e mbetjeve</i>	7
2.1.2 <i>Indikator C2: Pastërtia e qytetit</i>	8
2.1.3 <i>Indikatori C3: Perceptimi i publikut</i>	9
2.2 INDIKATORËT E QËNDRUESHMERISË MJEDISORE	10
2.2.1 <i>Indikatori D1: “Ripërdorimi – shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve”</i>	10
2.2.2 <i>Indikatori D2: “Shkalla e trajtimit të mbetjeve në lëndfill inxhinierik apo vend depozitime të kontrolluara dhe të aprovuara”</i>	10
2.3 INDIKATORËT E QËNDRUESHMERISË EKONOMIKE DHE INSTITUCIONALE	11
2.3.1 <i>Indikatori E1: “Rikuperimi i kostos përmes tarifës”</i>	11
2.3.2 <i>Indikatori E2: “Niveli i mbledhjes së tarifave”</i>	11
2.3.3 <i>Indikatori E3: “Transparenca e sistemit të tarifimit”</i>	11
3. SUGJERIME PËR ORGANIZIMIN E SHËRBIMIT TË GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIT	13
3.1 ORGANIZIMI I SHËRBIMIT	13
3.2 PRODHIMI I MBETURINAVE DHE PËRBËRJA E TYRE	13
3.3 PIKAT E PËRKOSSHME TË GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE (PGM)	15
3.4 FREKUENCA E GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE	17
3.5 INTENERARËT E GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE.....	17
3.6 MIRËMBAJTJA E KONTENIERËVE.....	21
3.7 FSHIRJA E RRUGËVE.....	21
3.8 MJETET E NEVOJSHME PËR TRANSPORTIN E MBETJEVE DHE LLOGARITJA E KOHËS SË GRUMBULLIMIT	22
3.9 KËRKESAT PËR FUQI PUNTORE	25
3.10 RICIKLIMI	25
3.11 FUSHATAT E INFORMIMIT	27
4. LLOGARITJA E KOSTOS SË SHËRBIMIT PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE NË NJA VELIPOJË DHE DAJC	28
4.1 LLOGARITJA E KOSTOS PËR NJA VELIPOJË DHE DAJC	28

4.2	LLOGARITJA E KOSTOS PËR SEZONIN TURISTIK NË VELIPOJË	33
-----	--	----

Lista e Tabelave

TABELA 2.1: INDIKATORËT E PERFORMANCËS	7
TABELA 2.2: LLOGARITJA E INDIKATORIT C1: “EFICENCA NË GRUMBULLIMIN E MBETJEVE” PËR NJA VELIPOJË DHE DAJC.....	8
TABELA 2.3: INDIKATORI C2: “EFEKTIVITETI NË GRUMBULLIMIN DHE FSHIRJEN E RRUGËVE”	8
TABELA 2.4: LLOGARITJA E INDIKATORIT C2: “EFEKTIVITETI NË GRUMBULLIMIN DHE FSHIRJEN E RRUGËVE” PËR NJA VELIPOJË DHE DAJC.....	9
TABELA 2.5: LLOGARITJA E INDIKATORIT D2: “SHKALLA E TRAJTIMIT TË MBETJEVE SIPAS LEGJISLACIONIT” PËR NJA VELIPOJË DHE DAJC	10
TABELA 2.6: LLOGARITJA E INDIKATORIT E1: “MBULIMI I KOSTOS PËRMES TARIFAVE” PËR NJA VELIPOJË DHE DAJC.....	11
TABELA 2.7: LLOGARITJA E INDIKATORIT E2: “NIVELI I MBLEDHJES SË TARIFAVE” PËR NJA VELIPOJË DHE DAJC.....	11
TABELA 8: INDIKATORI E3: “TRANSPARENCA E SISTEMIT TË TARIFIMIT”	12
TABELA 2.8: INDIKATORËT E PERFORMANCËS PËR NJËSITË ADMINISTRATIVE VELIPOJË DHE DAJC.....	12
TABELA 3.1: PRODHIMI MESATAR DITOR DHE VJETOR I MBETJEVE NË NJA VELIPOJË DHE DAJC.....	14
TABELA 3.2: PËRBERJA MERCOLOGJIKE E MBETJEVE NË SHKODËR DHE NË DISA NJA TË SAJ	15
TABELA 3.3: NUMRI I KONTENIERËVE TË NEVOJSHËM PËR NJA VELIPOJË DHE DAJC	16
TABELA 3.4: NUMRI I KONTENIEREVE QË NEVOJITET NË ZONËN E RËRËS	20
TABELA 3.5: NUMRI DHE KARAKTERISTIKAT E MJETEVE TEKNOLOGJIKE TË NEVOJSHME PËR TRANSPORTIN E MBETJEVE.....	23
TABELA 3.6: KOHA E NEVOJSHME PËR GRUMBULLIMIN E MBETJEVE	24

Lista e Figurave

FIGURA 1 PLANI I VENDOSJES SË KONTENIEREVE NË AKSIN KRYESOR TË RRUGËVE NACIONALE.....	18
FIGURA 2 INTENERARËT E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE NË NJA VELIPOJË DHE DAJC	19
FIGURA 3 RRUGËT QË DO TË FSHIHEN NË NJA VELIPOJË	22

Hyrje

Në kuadër të reformës së re territoriale Bashkia e Shkodrës është zgjeruar dhe tashmë përfshin edhe disa njësi të tjera administrative si: Ana e Malit, Bërdice, Dajc, Guri i zi, Postrisë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë. Në drejtim të menaxhimit të mbetjeve, nga njëra anë bashkia e Shkodrës duhet të zgjerojë kufinjtë e shtrirjes së këtij shërbimi edhe në njësitë e reja administrative, dhe nga ana tjetër ligji organik e detyron këtë bashki si dhe gjithë bashkitë e tjera të masë dhe të monitorojë performancën e këtij shërbimi.

Aktualisht bashkia Shkodër e ka kontraktuar shërbimin e pastrimit për njësinë administrative Shkodër tek operatori privat, përmes një kontrate 5 vjecare, e cila përfundon në Qershor të 2018. Në të njëjtën kohë bashkia është duke menaxhuar kontratat ekzistuese të kompanive private të pastrimit edhe në njësitë e tjera administrative. Kështu kontratat e shërbimit për Velipojën dhe Dajcin përfundojnë në fund të muajt Qershor, ndaj bashkia Shkodër është duke u përgatitur për të organizuar tenderin e pastrimit për një periudhë të përkohshme dy vjecare pra deri në Qershor të vitit 2018, vit në të cilin shërbimi i pastrimit do të riplanifikohet në të gjithë territorin e bashkisë Shkodër.

Në këtë kontekst ky dokument synon të lehtësojë punën dhe të ndihmojë Bashkinë Shkodër në hartimin e dokumentacionit teknik të tenderit për dy njësitë administrative Velipojë dhe Dajc.

Ky dokument do të fokusohet në:

- (i) Analizimin e situatës ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve për Njësitë Administrative (NjA) Velipojë dhe Dajc duke bërë vlerësimin e performancës së shërbimit aktual përmes gjithë indikatorëve të propozuar nga studimi i dldp-së
- (ii) Evidentimin dhe llogaritjen e kostos së shërbimit duke përdorur modelin e hartuar për llogaritjen e kostos dhe tarifave nga dldp.

1. Menaxhimi i mbetjeve në NjA Velipojë dhe Dajc

1.1 Qëllimi, objektivat dhe kufizimet e studimit

Ky dokument synon të japë disa këshilla praktike dhe të ndihmojë bashkinë e Shkodrës në hartimin e kontratës së re të pastrimit me kompanitë fituese të tenderit për NjA Velipojë dhe Dajc.

Dokumenti do të fokusohet në shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane në Njësitë Administrative (NjA) Velipoje dhe Dajc, ndërkohë që një kujdes të vecantë do të tregojë për organizimin e këtij shërbimi përgjatë sezonit veror në plazhin e Velipojës.

Mbetjet urbane të bio-degradueshme dhe jo të bio-degradueshme me origjinë nga banesat, lokalet, aktivitetet tregëtare si dhe nga hoteleritë dhe aktivitetet e tjera turistike do të jenë objekt i këtij studimi. Nderkohë që mbetjet spitalore të rrezikshme si dhe ato industriale nuk do të trajtohen në këtë raport.

1.2 Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbetjeve në NjA Velipojë

NjA Velipojë ndodhet 25 km larg qytetit të Shkodrës dhe ka një sipërfaqe prej 72.4 km². Ajo ka nën administrimin e saj 10 fshatra (Pulaj, Velipoje, Reç-Pulaj, Luarzë, Gomsiqe e Re, Baks Rrjoll, Mali Kolaj, Baks i Ri, Reç i Ri, Ças) me një popullsisë prej 9,536 banorësh (5,031 banorë sipas censusit). Pozita e favorshme gjeografike e njësisë administrative Velipojë, e ka kthyer atë në një nga zonat më atraktive për zhvillimin e turizmit detar, lumor dhe malor, të peshkimit dhe të gjuetisë, jo vetëm për bashkinë Shkodër por në gjithë pjesën veriore të Shqipërisë.

Plazhi i Velipojës është një nga zonat më të frekuentuara sidomos gjatë periudhës së verës. Në pjesën veriore të plazhit ndodhet grykëderdhja e lumit Buna ndersa në pjesën jugore të plazhit është laguna e Vilunit, duke i ofruar turistëve peisazhe natyror të vecanta.

Për më tepër, disa prej peisazheve natyrore në njesinë administrative Velipoje janë shpallur zona të mbrojtura. Më saktësisht, lumi Buna dhe ligatinat përreth si “Peisazhe ujore/ tokësore të mbrojtura”, ku Ishulli i Franc Jozefit, rezervati natyror i Velipojës, laguna e Vilunit, plazhi Baks-Rrjollit dhe kënetat e Domnit njihen zyrtarisht si zona të mbrojtura (Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002, VKM nr.682, datë 2.11.2005¹, dhe VKM nr. 683, datë 2.11.2005²).

1.2.1 Organizimi i shërbimit

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Njësinë Administrative (NjA) Velipojë është kontraktuar tek kompania private “Leka shpk”. Kjo kompani ka një kontratë me NjA nga Maj i vitit 2013 deri në Maj të vitit 2016. Në bazë të kontratës kjo kompani duhet të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

- organizimin ditor të shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve,
- transportit dhe depozitimit final të mbetjeve
- grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga zona e plazhit gjatë periudhës së verës (prill – tetor),
- Fshirjen dhe larjen e shesheve kryesore në qendër të NjA dhe në plazhin e Velipojës,
- organizimin e punëtorëve të pastrimit për zonën e plazhit (7 puntorë)
- Blerjen e 500 kontenerëve të rinj

1.2.2 Prodhimi i mbetjeve

Në NjA Velipojë nuk ka të dhënave të besueshme statistikore për popullsinë dhe prodhimin e mbetjeve. Numri i popullsisë rritet shumë përgjate sezonit të verës (Turistët e përkohshëm dhe ata ditorë) dhe kjo shoqërohet me ndryshimin edhe të normës ditore të prodhimit të mbetjeve.

¹ Për shpalljen e lumit Buna dhe peisazheve rreth tij si peisazhe tokësore/ ujore të mbrojtura”

² Për shpalljen e kompleksit ligator të Liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna si zona të mbrojtura

Të dhënat zyrtare nga NjA Velipojë në lidhje me numrin e popullsisë përgjatë sezonit veror janë shumë të debatueshme dhe mbështeten kryesisht mbi numrin e hoteleve dhe shtëpive të pushimit si dhe numrin e makinave që vizitojnë në një ditë vere plazhin. Po ashtu të dhënat për prodhimin e mbeturinave bazohen mbi numrin e kontenierëve apo kamionëve që transportojnë mbetjet për në vendin e depozitimit ku gjithësesi peshimi i mbetjeve nuk është realizuar ndonjëherë.

Përbërja mercologjike e mbetjeve në NjA Velipojë nuk njihet (ka disa sondazhe të bëra në zonat përreth Velipojës). Në mungesë të këtij informacioni është e vështirë të planifikohet drejt një menaxhim i integruar i mbetjeve (sic kërkohet nga legjislacioni aktual), i cili siguron që të gjitha rrymat e mbetjeve trajtohen më vete.

1.2.3 Grumbullimi dhe transporti

Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve ofrohet në shumicën e fshatrave të NjA Velipojë kryesisht përgjatë rrugëve kryesore të tyre. Ndërsa në zonën e plazhit shërbimi ofrohet vetëm gjatë periudhës së verës (maj – shtator). Nga vizita në terren u evidentua një mungesë e theksuar kontenierësh (disa prej tyre janë “fshehur” brenda hapësirave të brendshme të bizneseve) dhe një cilësi shumë e keqe e tyre. Për rrjedhojë rreth kontenierëve janë evidentuar përgje mbetjesh urbane, kryesisht me natyrë organike dhe bujqësore. Numri aktual i kontenierëve deklarohet 150, ndërkohë që firma e pastrimit detyrohet sipas kontratës të furnizojë NjA Velipojë edhe me 340 kontenierë të rinj.

Frekuencat e grumbullimit janë 1 herë në javë, ndërsa në zonën e plazhit dy herë në ditë vetëm gjatë sezonit të verës. Kontenierët zbrasen mekanikisht nga një kamion me ngjeshje automatike me kapacitet 10 ton.

1.2.4 Depozitimi i mbetjeve

Mbetjet janë transferuar në ish vend-depozitimin e komunës që ndodhet 4.4 km nga plazhi i Velipojës. Vendi i depozitimit ndodhet në fshatin Pulaj dhe rreth 800 metra larg rrjedhës së Lumit Buna dhe në të njëjtën kohë nga kufiri kombëtar me Malin e Zi. Vendi i depozitimit me një sipërfaqe prej rreth 0.9 ha, pa standarde sanitare, ndodhet lart në një kodër dhe rreth 3 metra thellë, ku mbetjet groposehin pa asnjë trajtim. Pas një përdorimi prej afro 10 vjetësh ky vend – depozitim është mbyllur dhe NjA Velipojë pritet që ti depozitojë mbetjet në lëndfillin e Bushatit.

1.3 Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbetjeve në NjA Dajç

Njësia Administrative Dajç ndodhet në jugperëndim të qytetit të Shkodrës, në një distance 22 km larg qendrës së qytetit. Njësia ka një sipërfaqe totale prej 36.5 km² dhe ka nën administrimin e saj 11 fshatrat, Dajç, Samrish i Ri, Samrish i Sipërm, Suka Dajç, Pentar, Belaj, Rrushkull, Shirq, Darragjat, Mali i Gjymtit dhe Mushan me një popullsisë prej 9,083 banorësh (3,885 banorë sipas censusit).

1.3.1 Organizimi i shërbimit

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në NjA Dajç është kontraktuar tek kompanitë private “Rozafa 94 shpk” dhe “Pastrimi Silvia shpk” me një nivel bashkëpunim 81% me 19%. Afati i kontratës së fundit ka qenë nga 30 Prill deri në 31 Dhjetor 2015. Kjo kompani ka një kontratë me NjA nga Maj i vitit 2013 deri në Maj të vitit 2016. Në bazë të kontratës këto kompani duhet të kryejë aktivitetet e mëposhtme:


- organizimin e grumbullimit të mbetjeve,
- transportit dhe depozitimit final të mbetjeve në landfillin e Bushatit

1.3.2 Prodhimi i mbetjeve

Edhe në këtë NjA, ashtu si në të gjitha NjA e bashkisë Shkodër nuk ka të dhëna të sakta për prodhimin e mbetjeve. Për më tepër në këtë NjA ka edhe një ndryshim të konsiderueshëm të numrit të popullsisë ndërmjet shifrave të raportuara nga rregjistrimi i fundit i CENSU-it me ato të raportuara nga njësia.

Përbërja mercologjike e mbetjeve në NjA Dajc është realizuar nga COSPE ne vitin 2010. Në figurën e mëposhtme jepen rrezultatet e marra nga ky studim.

Përberja mercologjike e mbetjeve në Dajc



1.3.3 Grumbullimi dhe transporti

Sistemi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet në të gjithë teritorin e NjA Dajc. Kontenierët janë të vendosur kryesisht përgjatë rrugës kryesore nacionale. Frekuencat e grumbullimit në grafik janë tre herë në jave por aktualisht shërbimi kryhet vetëm një herë në javë. Sasia e preventuar e mbetjeve rraportohet të jetë 518 ton.

1.3.4 Depozitimi i mbetjeve

Të gjitha mbetjet e grumbulluara nga kjo NjA janë depozituar në Landfillin e Bushatit. Raportohet që brenda një viti kjo NjA ka depozituar në landfillin e Bushatit 690 ton mbetje.

2. Vlerësimi i performancës së shërbimit në njësitë administrative Velipojë dhe Dajc

Sistemi me indikatorët që vlerësojnë performancën e shërbimit në menaxhimin e mbetjeve është zhvilluar për tu përdorur nga bashkitë si një instrument i monitorimit të shërbimit të dhënë në nivel vendor. Ai ndihmon në paraqitjen e qartë të situatës aktuale të menaxhimit të mbetjeve duke na krijuar njëkohësisht edhe mundësinë për të përcaktuar objektivat dhe targetet në nivele të arritshme.

Të gjithë indikatorët vlerësohen në fillim të procesit të planifikimit dhe më pas rishikohen cdo vit për të monitoruar performancën. Bashkia duhet të masë indikatorët cdo vit për të kuptuar zhvillimin dhe përshtatjen e objektivave apo targeteve nëse është e nevojshme. Të gjithë indikatorët duhet të raportohen cdo vit përpara Këshillit Bashkiak. Tabela e mëposhtme tregon një grup indikatorësh të zgjedhur për të reflektuar nivelin e performancës në menaxhimin e mbetjeve.

Tabela 2.1: Indikatorët e performancës

Indikatorët		Klasifikimi i koduar sipas ngjyrave			Niveli i saktësisë së të dhënave
		I ulët	I mesëm	I lartë	
					I ulët I mesëm I lartë
Cilësia e shërbimit	C1 Sipërfaqet e mbuluara me shërbim				
	<i>C1.1 Mbulimi i shërbimit në zonat urbane dhe gjysëm urbane</i>	0 – 40 %	41 – 80%	81 – 100%	
	<i>C1.2 Mbulimi i shërbimit në zonat rurale</i>	0 – 30 %	31 – 50%	51 – 100%	
	C2 Pastërtia e qytetit	0 – 32 %	33 - 66%	> 66%	
C3 Perceptimi i publikut: shkalla e kënaqësisë së publikut me shërbimin	0 – 50%	51 - 80%	81 - 100%		
Qëndrueshmëri a mjedisore	D1 Ripërdorimi: shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në zonat urbane	0 – 5%	5 – 20%	>20%	
	D2 Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e trajtimit të mbetjeve në landfille inxhinierike ose vend depozitime të kontrolluara dhe të aprovuara.	0 – 30%	31 – 70%	71 – 100%	
Qëndrueshmëria ekonomike dhe institucionale	E1 Rikuperimi i kostos: shkalla e mbulimit të koston nga tarifat	0 – 35%	36 – 70%	71 – 100%	
	E2 Kontributi i banorëve në financimin e shërbimit : shkalla e mbledhjes së tarifës	0 – 40%	41 – 75%	75 – 100%	
	E3 Transparenca e faturës së tarifimit	E ulët	E mesme	E lartë	
Kosto e shërbimit	Lek/toniLek / banorë / vit			

2.1 Indikatorët e cilësisë së shërbimit

2.1.1 Indikatori C1: Eficenca në grumbullimin e mbetjeve

Indikatori C1 shpreh sasinë e mbetjeve të grumbulluara në një bashki, nga autoritetet e ngarkuara për ta kryer këtë shërbim, në raport me sasinë totale të mbetjeve të prodhuara në këtë bashki.

$$C1.1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve të mbledhura në zonat urbane dhe gjysëm urbane} \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve të prodhuara në zonat urbane dhe gjysëm urbane} \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Sasia e mbetjeve të grumbulluara në të dyja Njësitë Administrative (NjA) Velipojë dhe Dajc janë vlerësuar bazuar mbi numrin e rrugëve të bëra dhe tonazhit të kamionëve që transportojnë mbetjet drejt vend depozitimit³. Ndërsa prodhimi i mbetjeve në NjA është vlerësuar duke u bazuar mbi koeficientët e dhënë në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Kështu që mund të themi se niveli i saktësisë së të dhënave është mesatar⁴.

Llogaritja e këtij indikatori për njësitë administrative Velipojë dhe Dajc paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2.2: Llogaritja e indikatorit C1: “Eficenca në grumbullimin e mbetjeve” për NjA Velipojë dhe Dajc

Eficenca në grumbullimin e mbetjeve	
Velipoja	Dajc
$C1.1 = \frac{2,650 \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{3,496 \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100 = 75.6\%$	$C1.1 = \frac{518 \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{706 \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100 = 73.4\%$

2.1.2 Indikator C2: Pastërtia e qytetit

Indikatori C2, “Efektiviteti në grumbullimin dhe fshirjen e rrugëve” është një indikator kualitativ i përbërë, i cili detajohet nga tre kritere vlerësimi. Përshkrimi i cdo kriteri dhe metoda e llogaritjes së këtij indikatori përshkruhet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2.3: Indikator C2: “Efektiviteti në grumbullimin dhe fshirjen e rrugëve”

N°	Kriteret	Përshkrimi	Vlerësimi	
C2.1	Efektiviteti në grumbullimin e mbetjeve	Prezenca e mbetjeve të akumuluarra përreth pikave të përkohshme të grumbullimit të mbetjeve	Presencë e lartë e mbetjeve (shumë të dukshme)	0
			Presencë e moderuar e mbetjeve (sporadike)	16
			Presencë e ulët e mbetjeve (pothuaj asgjë)	33
C2.2	Efektiviteti në fshirjen e rrugëve	Prezencë e mbetjeve në akset dhe rrugët kryesore.	Presencë e lartë e mbetjeve (shumë të dukshme)	0
			Presencë e moderuar e mbetjeve (sporadike)	16
			Presencë e ulët e mbetjeve (pothuaj asgjë)	33

³ Për NjA Dajc mbetjet peshohen në lëndfillin e Bushatit

⁴ Metodologjia për përcaktimin e performances bazuar në proceset e planifikimit të menaxhimit të mbetjeve, dldp 2016

C2.3	Efektiviteti i grumbullimit në zonat periferike	Presencë e mbetjeve të akumuluarra / vend	Presencë e lartë e mbetjeve (shumë të dukshme)	0
		depozitime ilegale / djegie	Presencë e moderuar e mbetjeve (sporadike)	16
		e mbetjeve në zonat periferike	Presencë e ulët e mbetjeve (pothuaj asgjë)	33

Vlerësimi i këtij indikator është realizuar duke u mbështetur në vëzhgimet e shpejta të bëra në terren dhe paraqitet në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2.4: Llogaritja e indikatorit C2: “Efektiviteti në grumbullimin dhe fshirjen e rrugëve” për NjA Velipojë dhe Dajc

N°	Kriteret	Përshkrimi	Velipoja	Dajc
C2.1	Efektiviteti në grumbullimin e mbetjeve	Prezenca e mbetjeve të akumuluarra përreth pikave të përkohshme të grumbullimit të mbetjeve	16%	16%
C2.2	Efektiviteti në fshirjen e rrugëve	Prezencë e mbetjeve në akset dhe rrugët kryesore.	16%	16%
C2.3	Efektiviteti i grumbullimit në zonat periferike	Presencë e mbetjeve të akumuluarra / vend depozitime ilegale / djegie e mbetjeve në zonat periferike	0%	0%

2.1.3 Indikator C3: Perceptimi i publikut

Indikator C3 është prezantuar në këtë grup si një indikator cilësor për Bashkinë. Banorët duhet të pyeten për të dhënë inputet e tyre në lidhje me perceptimin që ata në lidhje me cilësinë e shërbimit. Informacionet e marra nga banorët duhet të adresohen përgjatë procesit të planifikimit dhe duhen mbledhur e riparë në mënyrë periodike dhe të rregullt.

Pyetja që do të na shërbente për të llogaritur këtë indikator është: “A është shërbimi i grumbullimit të mbeturinave në banesën tuaj apo rrugën ku ju banoni i kënaqshëm”? Përgjigja do të jetë “po” ose “jo” dhe indikator do të matet me formulën e mëposhtme:

$$C3 = \frac{\text{Numri i përgjigjeve "po"}}{\text{Numri i personave të pyetur}} \times 100$$

Ky indikator nuk është llogaritur për NjA Velipojë dhe Dajc si pasojë e mungesës së të dhënave. Megjithatë sugjerohet që ky indikator të testohet në të dyja njësitë, dhe sidomos në njësinë e Velipojës gjatë sezonit turistik.

2.2 Indikatorët e qëndrueshmerisë mjedisore

2.2.1 Indikator D1: “Ripërdorimi – shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve”

Indikator D1 na paraqet sasinë e mbetjeve, të cilat në mënyrë të organizuar nga sektori formal, grumbullohen të vecuara sipas një cikli të mbyllur nga pikat e grumbullimit deri në qendrat e trajtimit, në raport me sasinë totale të mbetjeve të grumbulluara në atë bashki.

Sasia e mbetjeve të grumbulluara vecmas mund të paraqesë cdo lloj rryme mbetjesh të ndara nga cdo subjekt i autorizuar që nga faza e prodhimit, grumbullimit apo edhe ajo e trajtimit. Dhe me tej kjo sasi do të krahasohet me sasinë totale të mbetjeve të grumbulluara. Indikator D1 matet me formulën e mëposhtme:

$$D1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve të grumbulluar vecmas [ton/vit]}}{\text{Sasia totale e mbetjeve të grumbulluara [ton/vit]}} \times 100$$

Në të dyja NjA, si në Velipojë ashtu edhe në Dajc, nuk ekziston asnjë sistem grumbullimi i diferencuar i mbetjeve, të paktën nga subjekte të autorizuar. Megjithatë nga intervistat me funksionarë të këtyre njësiteve raportohet aktiviteti i sektorit informal, kryesisht në pikat e grumbullimit të përkohshëm të mbetjeve në akset kryesore të rrugëve. Të dhënat nga aktiviteti i sektorit informal janë vetëm cilësore (ata janë të interesuar kryesisht për hekur, alumini dhe plastik) dhe jo sasiore. Në këto kushte ky indikator merr vlerën 0% për të dyja NjA.

2.2.2 Indikator D2: “Shkalla e trajtimit të mbetjeve në lëndfill inxhinierik apo vend depozitime të kontrolluara dhe të aprovuara”

Ky indikator na paraqet sasinë e mbetjeve të trajtuara në qendra të autorizuar (lëndfille ose vend depozitime të kontrolluara dhe të aprovuara, qendra kompostimi, riciklimi, etj). Indikator D2 matet me formulën e mëposhtme:

$$D2 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve të trajtuara sic duhet}}{\text{Sasinë e mbetjeve të grumbulluara}} \times 100$$

Në njësinë administrative Dajc, e gjithë sasia e mbetjeve të grumbulluara raportohet që depozitohet në lëndfillin e Bushatit. Ndërsa në njësinë administrative Velipojë vetëm vitin e fundit një sasi e vogël e mbetjeve ka filluar të depozitohet në lëndfillin e Bushatit. Për këtë njësi ka ekzistuar një vend depozitim në afërsi të derdhjes së lumit Buna.

Llogaritja e këtij indikator për të dyja NjA jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2.5: Llogaritja e indikatorit D2: “Shkalla e trajtimit të mbetjeve sipas legjislacionit” për NjA Velipojë dhe Dajc

Shkalla e trajtimit të mbetjeve në përputhje me legjislacionin	
Velipoja	Dajc
$D2 = \frac{340 \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{3,496 \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100 = 9.7\%$	$D2 = \frac{690 \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{690 \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100 = 100\%$

2.3 Indikatorët e qëndrueshmërisë ekonomike dhe institucionale

2.3.1 Indikatorit E1: “Rikuperimi i kostos përmes tarifës”

Ky indikator krahason koston totale që nevojitet për të ofruar shërbimin e pastrimit me financimin e këtij shërbimi përmes grumbullimit të tarifave. Ky indikator matet me formulën e mëposhtme:

$$E1 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga tarifa e menaxhimit të mbetjeve} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Kosto vjetore e operimit për menaxhimin e mbetjeve} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Bazuar mbi të dhënat e mbledhura nga dy NjA, llogaritja e këtij indikatorit jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2.6: Llogaritja e indikatorit E1: “Mbulimi i kostos përmes tarifave” për NjA Velipojë dhe Dajc

Mbulimi i kostos përmes tarifave	
Velipoja	Dajc
$E1 = \frac{10.476.000 \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{19.000.000 \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100 = 55.14\%$	$E1 = \frac{705.600 \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{1.620.000 \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100 = 43.56\%$

2.3.2 Indikatorit E2: “Niveli i mbledhjes së tarifave”

Ky indikator paraqet kapacitetin/gadishmërinë e banorëve për të paguar tarifën e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Ky indikator llogaritet me formulën e mëposhtme:

$$E2 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore të grumbulluara nga tarifa e menaxhimit të mbetjeve} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Totalin e të ardhurave të planifikuara} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Bazuar mbi të dhënat e mbledhura nga dy NjA, llogaritja e këtij indikatorit jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2.7: Llogaritja e indikatorit E2: “Niveli i mbledhjes së tarifave” për NjA Velipojë dhe Dajc

Niveli i mbledhjes së tarifave	
Velipoja	Dajc
$E1 = \frac{10.476.000 \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{17.000.000 \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100 = 61.62\%$	$E1 = \frac{705.600 \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{980.000 \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100 = 72\%$

2.3.3 Indikatorit E3: “Transparenca e sistemit të tarifimit”

Ky indikator vlerëson kapacitetin e bashkisë për të ofruar një faturë të detajuar për të gjithë prodhuesit e mbetjeve. Ai është një indikator cilësor dhe vlerësohet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 2.8: Indikator E3: “Transparenca e sistemit të tarifimit”

Transparenca e sistemit të faturimit	Saktësia / besueshmëria
Nuk ekziston një sistem tarifimi për mbetjet	E ulët
Ka një sistem tarifimi të instaluar dhe prodhuesit marrin nje faturë	E mesme
Ekziston një sistem tarifimi Banorët kanë akses informacioni dhe kuptojnë llogaritjen e tarifës Mënyra se si cdo tarifë është llogaritur është e qartë dhe transparente për të gjithë prodhuesit e mbetjeve	E lartë

Për të dyja NjA Velipojë dhe Dajc, ky indikator është ndërmjet nivelit të ulët dhe të mesëm. Në të dyja njësitë i vetmi grup që merr një faturë është kategoria biznes. Gjithësesi edhe për këtë grup mënyra sesi është llogaritur tarifa nuk është e qartë dhe transparente. Ndërkohë që grupet e tjera që përfitojnë shërbimin sic janë banorët dhe institucionet nuk marrin asnjë faturë për tarifën që duhet të paguajnë si pasojë e shërbimit që marrin.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë në mënyrë të përmblodhur të gjithë indikatorët e llogaritur (aty ku ka qenë e mundur) për të dyja NjA Velipojë dhe Dajc:

Tabela 2.9: Indikatorët e performancës për Njësitë Administrative Velipojë dhe Dajc

	Indikatorët	Velipoja	Dajc	Saktësia e të dhenave
Cilësia e shërbimit	C1 Eficenca në grumbullimin e mbetjeve	75.6%	73.4%	Mesatare
	C2 Pastërtia e Njësisë Administrative	32%	32%	Mesatare
	C3 Shkalla e kënaqësisë së banorëve	E panjohur	E panjohur	

Qëndrueshmëri a mjedisore	D1 Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve	0%	0%	Mesatare
	D2 Trajtimi i duhur i mbetjeve	9.7%	100%	Mesatare
Qëndrueshmëria ekonomike dhe institucionale	E1 Rikuperimi i kostos	55%	44%	Mesatare
	E2 Shkalla e grumbullimit të tarifave	62%	72%	Mesatare
	E3 Sistemi transparent i tarifimit	I ulët	I ulët	Mesatare
Kosto e shërbimit	lek/ton			
	lek/banor/vit			

3. Sugjerime për organizimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit

3.1 Organizimi i shërbimit

Bashkia Shkodër është duke organizuar tenderimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për dy NjA Velipojë dhe Dajc. Pra ky shërbim, i cili do të përfshijë grumbullimin e mbeturinave nga banorët, bizneset dhe nga aktivitetet turistike, transportin e tyre drejt lëndfillit të Bushatit, fshirjen e disa akseve të asfaltuara në plazhin e Velipojës si dhe pastrimin mekanik të rrës (në Velipojë dhe Rjoll) dhe zonës së pyllit në lagunën e Vilunit, do të kontraktohet tek operatorët privat.

3.2 Prodhimi i mbeturinave dhe përbërja e tyre

Dy elementët më të rëndësishëm kur flasim për procese planifikuese, sic është edhe hartimi i kontratës për ofrimin e shërbimit, janë norma e prodhimit të mbeturinave dhe përbërja e tyre mercologjike. Të gjitha llogaritjet për të planifikuar infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve, llogaritjen e kostos së shërbimit apo edhe hartimin dhe planifikimin e politikave/programeve për minimizimin e mbetjeve varen drejt për së drejti nga këto dy parametra.

Një element po kaq i rëndësishëm për të përcaktuar sasinë ditore të prodhimit të mbeturinave është edhe numri i popullsisë. Numri total i popullsisë së përhërëshme që banon në NjA Velipojë raportohet të jetë 9,536 banorë, ndërsa në Dajc 9,083. Në Velipojë përgjatë sezonit veror, i cili zgjat nga Maj në Shtator, kemi një shtesë të konsiderueshme të numrit të banorëve të përkohshëm, si pasojë e arrdhes së turistëve dhe vizitorëve ditor.

Për më tepër në këtë NjA nuk ekziston ndonjë data base që të na orjentoj qartë për numrin e vizitorëve përgjatë sezonit veror në plazhet e Velipojës. Gjithësesi mendohet që ky numër të jetë mesatarisht 37,500 turistë në ditë.

Në të tilla kushte prodhimi mesatar ditor dhe vjetor i mbeturinave në NjA Velipojë dhe Dajc jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3.1: Prodhimi mesatar ditor dhe vjetor i mbetjeve në NjA Velipojë dhe Dajc

	Gjendja Civile	Census	Sasia e prodhuar e mbetjeve		
	Banorë		kg/banorë/ditë	ton/ditë	ton/vit
Banorë të përhershëm	9,536	5,031	0.4	2.01	735
Biznese të vogla		355	6	2.13	777
Biznese të mëdha		5	20	0.10	37
Institucione		20	10	0.20	73
Totali për Velipojën				4.44	1,621
Turistët sezonal në Velipojë		37,500	0.5	18.75	1,875
Banorë të përhershëm	9,083	3,885	0.4	1.55	567
Biznese të vogla		35	6	0.21	77
Biznese të mëdha		4	20	0.08	29
Institucione		9	10	0.09	33
Totali për Dajcin				1.93	706

Kështu që në NjA Velipojë dhe Dajc duhet të grumbullohen dhe të transportohen cdo ditë respektivisht 4.44 dhe 1.93 ton mbetje, ndërkohë që në Velipojë përgjatë sezonit turistik ka nevojë për të parashikuar grumbullimin dhe transportimin e 18.75 ton mbetje në ditë.

Megjithëse këto llogaritje janë të bazuara mbi disa supozime dhe saktësia e tyre konsiderohet si mesatare, sërish ato janë konsultuar me ekspert dhe përfaqësues të bashkisë Shkodër si dhe punonjës të kompanisë private për t'i krahasuar këto shifra me eksperiencën praktike.

Rekomandim 1. Për të përmirësuar dhe për t'iu afruar më afër realitetit është e sugjerueshme që bashkia Shkodër përgjatë këtyre dy viteve, duke i paraprirë ri-organizimit të shërbimit në të gjithë teritorin e saj, duhet të ndërtojë një sistem për regjistrimin e vizitorëve në plazhet e Velipojës dhe Rjollit si dhe të ndërmarrë fushata për konsumatorë të vecantë (banesa, hotele, pika tregtare, institucione etj) për përcaktimin e normës së prodhimit të mbetjeve. Gjithashtu firmat që ofrojnë shërbimin duhet të mbajnë rekorde mbi sasinë e mbeturinave që grumbullojnë, transportojnë dhe dorëzojnë në lëndfillin e Bushatit.

Në të dyja NjA, Velipojë dhe Dajc nuk ekzistojnë të dhëna të sakta përsa i përket llojit dhe sasisë së rrymave të ndryshme të mbetjeve. Kështu në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për përbërjen merceologjike për qytetin e Shkodrës⁵ dhe disa njësi administrative të saj⁶.

Tabela 3.2: Përberja merceologjike e mbetjeve në Shkodër dhe në disa NjA të saj

	Shkodër	Dajc	Bushat	Blinisht	Vau i Dejës	Hajmel
Organike	47 %	35 %	40 %	18 %	49 %	35 %
Leter	13 %	17 %	9 %	7 %	9 %	8 %
Plastike	13 %	11 %	27 %	15 %	10 %	9 %
Qelq	5 %	20 %	8 %	22 %	15 %	40 %
Metale	1 %	4 %	1 %	4 %	1 %	2 %
Te tjera	21 %	14 %	16 %	33 %	15 %	5 %

Bazuar mbi ligjin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, bashkia e Shkodrës duhet të fillojë të planifikojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve për të realizuar riciklimin dhe kompostimin e tyre. Ky shërbim duhet të fillojë të planifikohet edhe në NjA Velipojë dhe Dajc.

Rekomandim 2. Për të planifikuar sa më saktë kostot e infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në Velipojë dhe Dajc, duket që këto NjA të realizojnë fushata për analizimin e mbetjeve në konsumatorë të vecantë (banesa, hotele, pika tregëtare, institucione etj) për përcaktimin e normës së prodhimit të rrymave të ndryshme të mbetjeve.

3.3 Pikat e përkohshme të grumbullimit të mbetjeve (PGM)

Duke u bazuar mbi sasinë ditore të prodhimit të mbeturinave si dhe mbi disa variabla fikse si: densiteti mesatar i mbetjeve, kapaciteti i kontenierëve, koeficienti i mbushjes së kontenierit, në tabelën e mëposhtme, janë llogaritur numri i kontenierëve (pikave të grumbullimit të përkohshëm) për NjA Velipojë dhe Dajc.

⁵ Fushata për ndarjen e mbetjeve e realizuar nga Co-PLAN në 8 qytete shqiptare, përfshirë Shkodrën, në kuadrin e projektit INPAEL “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor” (INPAEL 2010)

⁶ Fushata për ndarjen e mbetjeve e realizuar nga Co-PLAN në pesë NJQV në rajonin e Shkodrës në kuadrin e projektit “Studimi i Ndarjes së Mbetjeve në 5 NJQV në rajonin e Shkodrës” (COSPE 2010)

Tabela 3.3: Numri i kontenierëve të nevojshëm për NjA Velipojë dhe Dajc

	<i>Sasia mesatare vjetore</i>	<i>Sasia mesatare ditore</i>	<i>Frekuenca e propozuar</i>	<i>Densiteti mesatar i mbetjeve</i>	<i>Kapaciteti i konteniereve</i>	<i>Koeficienti i mbushjes</i>	<i>Nevoja per konteniere</i>
	ton/vit	ton/ dite	dite/ jave	ton/m ³	m ³	%	copë
Velipojë	1,621	4.44	2	0.15	1.1	85	130
Dajc	706	1.93	2	0.15	1.1	85	57
Velipoja Plazh	1,875	18.75	14	0.15	1.1	85	78
Total	4,202	25.13					261

Nga tabela e mësipërme duket qartë që numri i nevojshëm i kontenierëve për NjA varet shumë nga frekuenca e grumbullimit të mbetjeve. Literatura sugjeron që për një NjA e cila prodhon më shumë se 2 ton mbetje në ditë të ketë një frekuencë për grumbullimin e mbetjeve të paktën dy here në javë. Ky është rasti për të dyja NjA Velipojë dhe Dajc. Ndërkohë që për NjA Velipojë gjatë sezonit turistik (mesatarisht 100 ditë) ka nevojë edhe për 80 kontenierë shtesë në qoftë se marrim në konsideratë faktin që mbetjet do të grumbullohen dy here në ditë, cdo ditë të javës.

Si përfundim mund të themi që sistemi i grumbullimit të përkohshëm të mbetjeve në NjA Velipojë do të përbëhet nga 130 kontenierë ndërsa ai i NjA Dajc nga 60 kontenierë. Gjatë sezonit turistik në Velipojë do të shtohen edhe 80 kontenierë për të përballuar fluksin e mbetjeve të prodhuara nga turistët.

Kontenierët do të përdoren për grumbullimin e mbetjeve urbane të miksuara dhe duhet të kenë karakteristikat si më poshtë vijojnë:

- Kontenieri duhet të jetë në gjendje të durojë gjatë kohës, për të gjithë përbërsit, temperatura nga -20°C deri +50°C;
- Peshë minimale e kontenierit duhet të jetë 99 kg, dhe duhet të kenë një kapacitet mbajtës prej 1100 litra. Kontenieri duhet të jetë i strukturuar në mënyrë që të garantojë një mbajtje peshe deri në 450kg, pa pësuar asnjë deformim permanent.
- Trupi i kontenierit duhet të jetë i zinguar për të siguruar mbrojtje nga korrozioni. (vaska e galvanizuar me të nxehtë) dhe më pas i lyer me bojë speciale nga jashtë (me pjekje), rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe përdorimit. Spesori i profilit të vaskës minimumi duhet të jetë 1.5 mm;
- Kontenieri duhet të jetë i paisur me sistem kullimi fundor për derdhjen e lëngjeve të grumbulluar nga mbetjet apo gjatë larjes së kontenierit. Duhet të jetë i pajisur me doreza anesore për terheqjen e kontenierit.
- Kontenieri duhet të jetë i pajisur me kapak, i cili duhet të jetë i harkuar ose i pajisur me kanale për të lejuar rrjedhjen e ujrave të shihut. Sistemi i hapjes së kapakut duhet të jetë me pedale qendrore. Pedalja duhet të jetë me profil metalik me spesor 4 mm për ekstra rezistencë. Kapaku duhet të jetë i pajisur me dy doreza, në pjesën e përparme ose anesore, për raste të hapjes së kapakut në mënyrë manuale.
- Sistemi i kapjes së rrotave me trupin e kontenierit duhet të jetë i përforcuar me një bazë ekstra e lidhur me trupin e kontenierit. Rrota duhet të jenë rezistente me çelik të galvanizuar në qendër dhe unazë gome

rezistente në pjesën e kontaktit me tokën. Diametri i rrotës 200mm dhe me rrotullim 360°. Kontenieri duhet të jetë i pajisur me 4 rrota të kthyeshme (me kokë rrotulluese), me kapacitet ngarkese që kalon 200 kg secila, me gomë plastike solide, me kuzhineta. Dy nga rrotat duhet të jenë të pajisura me frena.

- Kompania duhet të sigurojë dhe ngjisë adezivin kryesor në pjesen ballore të kontenierit. Dimensionet e adezivit do të jenë jo më pak se 70% e sipërfaqes ballore të kontenierit. Adezivi kryesor do të ketë mesazhe promovionale të dakortësuara me njësitë administrative ku do të vendosen. Adezivi duhet të jetë me ngjyra dhe duhet t'i durojë kushteve atmosferike. Gjithashtu kontenierët duhet të jenë të paisur me adezivë për ndalim parkimi para kazanëve si dhe me shenja me vija me ngjyrë fosforeshente;

3.4 Frekuenca e grumbullimit të mbetjeve

Në NjA Velipojë dhe Dajc shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet dy here në javë, të hënën dhe të premten. Oraret e grumbullimit sugjerohet të jenë herët në mëngjes ose vonë në mbrëmje, kështu do të evitohen orët me trafik. Megjithatë për përcaktimin e orareve të grumbullimit një tjetër faktor që mund të jetë përcaktues është edhe aktiviteti i kompanisë private që do të ofrojë shërbimin, dhe fakti nëse ajo do të jetë e përfshirë apo jo me ofrimin e shërbimit në të tjera NjA. Nëse ky do të jetë rasti atëherë oraret e shërbimit do të integrohen në aktivitetin ditor të kompanisë në mënyrë të tillë që të kemi një optimizim të të gjitha burimeve të saj.

Në mënyrë të vecantë për NjA Velipojë përgjatë sezonit turistik PGM, frekuencat dhe oraret e grumbullimit duhet të përshtaten në përputhje me ritjen e numrit të popullsisë. Kështu përgjatë këtij sezoni nevojiten rreth 80 kontenierë më tepër për t'u shpërndarë në pjesën urbane të plazhit të Velipojës. Mbetjet do të grumbullohen dy here në ditë, cdo ditë të javës (përgjatë periudhës Qershor – Shtator). Do të punohet me dy turne dhe orët e operimit për turnin e pare do të jenë ndërmjet 14.00 dhe 16.00, ndërsa për turnin e dytë do të jenë përgjatë natës ndërmjet orës 23.00 dhe 01.00.

Rekomandim 3. Është shumë e rëndësishme që bashkia të ndërmarrë një fushatë informimi për të gjitha kategoritë e përfituesëve të shërbimit (banorët, hotelet, aktivitetet komerciale etj) pësa i përket orareve të depozitimit të mbetjeve në PGM. Synimi duhet të jetë afrimi i orareve të depozitimit të mbetjeve në PGM me oraret e evakuimit të mbetjeve për të minimizuar kohën e qëndrimit të mbetjeve në PGM. Fokusi duhet të jetë tek subjektet që prodhojnë sasira të mëdha mbetjesh apo mbetjesh voluminoze.

3.5 Intenerarët e grumbullimit të mbetjeve

Në të dyja NjA kontenierët do të vendosen sipas historikut të tyre, buzë akseve të rrugës kryesore (cdo 250 – 300 metra distance) dhe në brendësi të zonave të banueshme sipas dendësisë së popullsisë, aksesit për lëvizjen e kamionit teknologjik, pozicionit të bizneseve dhe aktiviteteve komerciale.

Rekomandim 4. Për të gjitha PGM (të përbëra kryesisht nga 3 kontenierë) që ndodhen në aksin kryesor të rrugës nacionale duhet të ndërtohen xhepa mbrojtës me bazament betoni për të larguar disi kontenierët nga rruga dhe për të mbrojtur shkatërimin e rrotave të tyre. Keto xhepa mund të përdoren edhe për vendosjen e reklamave apo informacioneve sensibilizuese. Ndërsa për kontenieret që nuk ndodhen në akset kryesore të shtrohen bazamentet e tyre me beton për të lehtësuar lëvizjen e tyre me peshë dhe për të shmangur dëmtimin e tyre.




Figura 1 Plani i vendosjes së konteniereve në aksin kryesor të rrugëve nacionale

Në figurën e mëposhtme paraqiten intenerarët e grumbullimit të mbetjeve për njësitë administrative Velipojë dhe Dajç. Në të dyja NjA vendet e përcaktuara të PGM dhe intenerarët e grumbullimit do vazhdojnë të jenë të njëjta si edhe në kontratën e mëparshme, ndërsa për pjesën e plazhit në Velipojë përgjatë sezonit turistik skema e grumbullimit do të jetë e ndarë në tre linja kryesore.




Figura 2 Intenerarët e grumbullimit të mbeturinave në NjA Velipojë dhe Dajç

Kështu e gjithë zona e plazhit të Velipojës është ndarë në tre unaza grumbulluese, sipas tipologjisë së zones, përqëndrimin të popullsisë dhe aksesit aktual të rrugëve ekzistuese, të cilat plotësojnë kriteret e lëvizjes së mjeteve teknologjike që do të grumbullojnë mbetjet. Unaza e parë fillon nga hyrja në zonën e plazhit të Velipojës (tek kthesa e ushtarit) dhe vazhdon deri në qendër të Velipojës plazh dhe ka një gjatësi 3.5 km. Unaza e dytë fillon nga Velipoja Plazh qendër dhe vazhdon deri në Pyllin e Vilunit dhe është e gjatë 3.7 km. Për secilën unazë janë propozuar 15 – 18 pika të përkohshme të grumbullimit të mbetjeve. Numri i kontenierëve në cdo PGM do të jetë mesatarisht 3 por do të ketë edhe pika me dendësi të lartë të popullsisë (si për shembull tek godinat e Fishtajve) ku ky numër mund të jetë edhe më i lartë. Gjithësesi numri i kontenierëve në të gjitha PGM do të rregullohet dhe përshtatet nga kompania që do të ofrojë shërbimin dhe supervizorët e bashkisë në bazë të monitorimeve të javëve të para.

Rekomandim 5. Gjithësesi është e rëndësishme që jo vetëm në aksin kryesor por në të gjitha PGM ku do të vendosen kontenerët të ndërtohen bazamentet e betonit ku do të rinë kontenerët, të cilat duhet të jenë të paisura me fletë mbrojtëse llamarine që rrethojnë PGM të paktën nga të treja anët. Kjo jo vetëm që do të fiksonte vendet e kontenerëve dhe nuk do të lejonte zhvendosjen e tyre por edhe do të ruante këto të fundit nga dëmtimet apo rrëzimet e tyre.

Një tjetër unazë grumbulluese do të përfshijë evadimin e mbetjeve të prodhuara nga pushuesit në zonën e rërës së plazhit. Kjo unazë shtihet përgjatë gjithë zones pedonale dhe përmban disa PGM. Gjithësesi ky numër do të përcaktohet në bazë të parcelave të plazhit të dhëna me qera (plazhet private). Skema do të funksionojë në këtë mënyrë: Të gjithë sipërmarrësit privat që do të menaxhojnë plazhet private duhet të sigurojnë një sistem grumbullimi me kosha portative ose konteniere të vegjël për të siguruar që parcela e tyre e plazhit do të jetë e pastër gjatë gjithë kohës. Ndërsa firma private do të ofrojë makinën e vogël (të quajtur satelit) e cila do të eci përbri pedonale dhe do të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve të rërës disa here në ditë (cdo ditë të javës të paktën dy herë por në weekende të paktën 3 herë). Makina satelit në përfundim të unazës do të bëjë shkarkimin tek makina teknologjike në pikën e caktuar të unazës së dytë grumbulluese sic paraqitet në figurën 2.

Nërsa për plazhet publike, firma e pastrimit duhet të punësojë fuqi puntore (10 puntorë) me kohë të pjeshme, për të bërë të mundur pastrimin dhe mirëmbajtjen e plazheve publike nga mbeturinat. Supervizorët e bashkisë do të monitorojnë skemën dhe do të bëjnë raportimet përkatëse të funksionimit të saj.

Rekomandim 6. Përpara sesa të jepen lejet e shfrytëzimit për zonën e plazhit tek sipërmarrësit privat, bashkia duhet të hartojë me kujdes detyrimet dhe sanksionet përkatëse për cdo sipërmarrës në kontratat respective përpara i përket detyrimit që ata duhet të ketë për ofrimin e shërbimit të grumbullimit dhe mbajtjen pastër sipas të gjitha normave higjieno sanitare të parcelës së plazhit që ai do të shfrytëzojë.

Gjithësesi për të përcaktuar numrin e kontenerëve në këtë unazë grumbulluese janë bërë supozimet e mëposhtme: bazuar mbi eksperiencën janë rreth 120 parcela plazhi që jepen për shfrytëzim me qera përgjatë sezonit turistik me një sipërfaqe mesatarisht 500 m² secila. Duke supozuar që cdo njëra prej tyre ka të paktën 50 cadra me dy shezllon secila, i bie që në total në plazhet private mund të akomodohen rreth 12,000 persona Në tabelën e mëposhtme llogaritet numri i kontenerëve që nevoiten në zonën e plazhit.

Tabela 3.4: Numri i konteniereve që nevojitet në zonën e rërës

Plazhet private	Cadrat për plazh	Kapaciteti mesatar mbajtes i plazheve		Sasia e mbetjeve të prodhuara ne plazh	Kapaciteti i konteniereve të nevojshëm për zonën e plazhit	
		Private	Publike		0.25 m ³	1.1 m ³
Nr	Nr.			ton/dit		
120	50	12,000	25,000	7.4	142	32

Duke u bazuar në supozimet dhe llogaritjet e mësipërme propozohet që për cdo plazh privat të dhënë me qera, shfrytëzuesi i tij duhet të vendosë të paktën 1 kosh 0.25 m³ për grumbullimin e përkohshëm të mbetjeve të prodhuara në rërë (këtë detyrim duhet ta ketë të specifikuar në kontratë). Shfrytëzuesi i plazhit duhet të

mirëmbajtje dhe të mbledhë (krijojë mundësi për pushuesit) mbetjet brenda hapësirës së tij, ndërsa kompania private e pastrimit duhet të sigurojë grumbullimin e ketyre mbetjeve me një kamioncinë 3 ton. I njëjti mjet duhet të grumbullojë edhe kontenierët që duhet të vendosen në plazhet publike (të paktën 30 kontenierë 0.25 m^3).

Kontenierët do të vendosen në fund të parcelave të plazhit në kufi me pedonalen duke i krijuar mundësi kamioncinës për të bërë grumbullimin e tyre. Frekuenca e grumbullimit do të jetë të paktën 3 herë në ditë, cdo ditë të javës, ndërkohë që gjatë weekendit sipas nevojave mund të bëhet edhe 4 herë në ditë. Mbetjet e grumbulluara përgjatë këtij intenerari do të shkarkohen në një nga kamionët teknologjik që mbledhin mbetjet në unazat grumbulluese të plazhit.

Rekomandim 7. Për të ardhmen nëse bashkia do të sigurojë aksesin rrugor për mjetin teknologjik 5 ton në anën tjetër të pedonales (pra jo në rërë) kjo skemë grumbullimi mund të përmirësohet dhe të bëhet më efiçente. Kontenierët mund të standartizohen dhe të kthehen në kontenierë 1.1 m^3 , të cilët mund të vendosen përgjatë pedonales dhe të dyja unazat grumbulluese në plazh mund të zgjerohen deri në kufi me pedonalen. Do të jenë sërisht pronarët e plazheve ata që do të kenë përgjegjësinë për të grumbulluar mbetjet në hapësirat e tyre si dhe punëtorët sezonal të bashkisë/firmës për pastrimin e plazheve publike, por do të shmanget kalimi i makinës në rërë dhe do të largohen PGM nga rëra në anën tjetër të pedonales.

3.6 Mirëmbajtja e kontenierëve

Kompania duhet të jetë e detyruar përgjatë gjithë kohës që do ushtrojë aktivitetin e saj që të bëjë inventarizimin e kontenierëve dhe në mënyrë sistematike të riparojë kontenierët e dëmtuar. Për të realizuar këtë aktivitet kompania duhet të ketë paisjet e nevojshme që përfshijnë kamionin që do të sigurojë transportimin e kontenierëve të dëmtuar si dhe oficinën dhe stafin përkatës për riparimin e tyre.

Dëmtimet kryesore të cilat fillimisht duhet të shmangen dhe më pas të riparohen në mënyrë të menjëhershme janë: dëmtimi i rrotave, kapaku dhe dorezat si dhe deformimet në trupin e kontenierit. Kompania duhet të shmang përplasjet e kontenierit pas shkarkimit në makinën teknologjike dhe hedhjen e tij në pozicionin fillestar.

Cdo pike e grumbullimit dhe kontenierët përkatës duhet të pastrohen dhe të lahen të paktën një here në muaj (gjatë sezonit turistik në plazhin e Velipojës një here në dy javë). Për të realizuar këtë aktivitet kompania duhet të ketë në dispozicion paisjet dhe mjetet përkatëse.

Megjithatë për të siguruar që cilësia e grumbullimit nuk do të cënohet nga dëmtimet e kontenierëve kompania duhet të ketë të paktën një rrezerve prej 10% të sasisë totale të kontenierëve të nevojshëm për cdo NJA.

3.7 Fshirja e rrugëve

Shërbimi i fshirjes së rrugëve do të aplikohet vetëm në Velipojë, në zonën e plazhit në rrugët e treguara në skicën e mëposhtme (përfshihen rrugën hyrëse drejt qendrës me dy korsi, rrugët e brendshme në lulishten kryesore të qendrës si dhe rruga përgjatë ndërtimeve tek Fishtajt).

Fshirja manuale e ketyre rrugëve dhe shesheve nënkupton, largimin e mbeturinave, gjetheve dhe barit të lulishteve si dhe të baltës dhe plurave. Të gjitha materialet e mbledhura duhet të depozitohen në pikat e grumbullimit të përkohshëm të mbeturinave dhe jo të depozitohen në ndonjë vend tjetër. Kompania duhet të sigurojë që kjo rrymë mbetjesh nuk përfundon në kunetat dhe kanalet e ujrave të shiut.

Parashikohet që në total të fshihen rreth 300,000 m² sipërfaqe rruge. Frekuenca e fshirjes do të jetë një here në ditë herët në mëngjes dhe do të kryhet nga puntorët sezonal me fshesa cdo ditë të javës nga e hëna deri të djelën.

Çdo punëtor duhet të jetë i pajisur me mjete të përshtatshme të tilla si një karrocë dore, fshesa si dhe një lopatë për marrjen e mbeturinave. Punëtorët duhet të kenë veshjet e përshtatshme të punës dhe me shenjat dalluese të kompanisë.



Figura 3 Rrugët që do të fshihen në NjA Velipojë

3.8 Mjetet e nevojshme për transportin e mbetjeve dhe llogaritja e kohës së grumbullimit

Bazuar tek llogaritjet e prodhimit të mbetjeve, numri i kontenierëve, numri i turneve për cdo ditë, kapaciteti i kamionit dhe tek eksperiencia e kryerjes së këtij shërbimi në të dyja NjA Velipojë dhe Dajç, në tabelat e mëposhtme po paraqesim në mënyrë të përmbledhur llogaritjen e numrit të nevojshëm për mjete teknologjike për kryerjen e transportit të mbetjeve nga këto njësi drejt landfillit të Bushatit.

Tabela 3.5: Numri dhe karakteristikat e mjeteve teknologjike të nevojshme për transportin e mbetjeve

	Sasia e mbetjeve	Numri i rrugëve/dite	Kapaciteti i mjeteve		Ditët e punës së makinës	Nevoja për tu transportuar		Nevoja për makina
	(ton/vit)	Rruge/ dite	m3	ton	ditë	trsp/vit	trsp/ditë	nr.
Velipoja dhe Dajç	2,327	2	18	10	104	232.7	2.2	1.1
Velipoja Plazh	1,875	2	10	5	100	375.0	3.8	1.9
Velipoja Rërë	770	3	6	3	100	256.7	2.6	0.9

Për të realizuar transportimin e mbetjeve të prodhuara në Velipojë dhe në Dajç, me një frekuencë grumbullimi dy herë në javë, nevojitet një makinë teknologjike me kapacitet 10 ton e cila do të punojë me dy turne në ditë. Ndërkohë që përgjatë sezonit turistik në Velipojë nevojiten edhe 2 makina të tjera teknologjike me kapacitet 5 ton secila (aksesi i rrugëve në pjesën e plazhit në Velipojë e ben të pamundur përdorimin e një kamioni teknologjik 10 ton). Gjithashtu një tjetër kamioncine 3 ton nevojitet për të grumbulluar mbetjet e prodhuara në pjesën e rërës. Përgjatë sezonit turistik të dyja mjetet teknologjike (5 ton) dhe kamioncina e hapur (3 ton) do të transportojnë mbetjet me një frekuencë tre herë në ditë, cdo ditë të javës.

Makinat teknologjike duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Ato duhet të jenë në gjendje të mirë teknike për të mundësuar mbledhjen e 10 ton mbetje në Velipojë dhe në Dajç, në më pak se katër orë.
- Makinat teknologjike duhet të kenë një sistem ngarkimi të përshtatshëm me kontenierët që do të përdoren në të dyja NjA.
- Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë i gjithi funksional dhe të lejojë kryerjen e nje cikli të plotë (ngritjen e kontenierit, shkarkimin dhe uljen e tij (130 kg) në një periudhë kohore të limituar prej 20 sekondash.
- Sistemi mekanik i ngritjes duhet të funksionojë vete dhe nuk duhet që puntorët të ngrënë kontenierin për ta varur atë në këtë sistem.
- Makinat teknologjike duhet të jetë në një gjendje të mire, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arsye mekanike. Gjithashtu ato duhet të jetë i aftë për të lëvizur me një shpejtësi prej 80 km/h.
- Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të jenë në përputhje me normat e legjisllacionit në fuqi.

- Dritat e përparme dhe të pasmet duhet të jenë në gjendje të mire dhe makinat duhet të jetë gjithashtu të pajisur me reflektorë.
- Makinat teknologjike duhet të jenë të pajisur me pasqyra të jashtme për të pasur një vision të qartë mbrapa, me mbajtëse/suport për puntorët, me sistem komunikimi (radio ose telefona) të cilat duhet të jenë të lidhura me qendrën e operimit.
- Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të lejuar një shkallë të mirë ngjeshje për të realizuar ngarkimin e sasisë së kërkuar të mbeturinave brenda volumit të kamionit (respektivisht 10 dhe 5 ton)
- Të gjitha investimet, mirëmbajtja dhe në qoftë se është e nevojshme edhe kostot e zëvendësimit të pjesëve janë të gjitha për t'u paguar nga kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e makinave teknologjike dhe për faktin që ata duhet të jenë të gjithë në gjendje pune.
- Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tilla situata nuk duhet të kenë ndonjë influence apo ndikim mbi sasinë dhe cilesinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.
- Makinat teknologjike duhet të lahen cdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një grumbullim të sigurt, të pastër dhe higjienik të mbetjeve.
- Shoferi duhet të mbajë një libër ditor ku të tregojë të gjithë informacionin për punën e bërë cdo ditë: orën kur ka filluar grumbullimi, pushimet gjatë shërbimit, orët e shkarkimit, rrugët e bëra dhe numrin e kontenerëve të mbledhur.
- Kompania duhet të ketë gjithashtu një regjistër për cdo makinë teknologjike, ku të jepet i gjithë informacioni në lidhje me karburantin (datat, orët dhe sasinë), vajin dhe të tjera aktivitete të mirëmbajtjes.
- Në qoftë se makinat teknologjike nuk do të plotësojnë këto kërkesa, si pasojë e neglizhencës në mirëmbajtje nga kompania, atëherë njësitë administrative duhet të kërkojnë zëvendësimin e tyre.

Nga studime të tjera të realizuara nga dldp, për njësi administrative me të njëjtat karakteristika urbanizimi si Velipoja dhe Dajci, është supozuar se koha e nevojshme mesatare për grumbullimin e mbetjeve në një PGM është 2.7 – 5 min. Në tabelën e mëposhtme është parashikuar koha e nevojshme që nevojitet për të grumbulluar mbetjet në të dyja NjA.

Tabela 3.6: Koha e nevojshme për grumbullimin e mbetjeve

	<i>Numri i kontenerëve</i>	<i>Numri i kontenerëve për PGM</i>	<i>Koha efektive e grumbullimit për 1 PGM</i>	<i>Koha e nevojshme për grumbullimin</i>	
	copë	copë	Min	minuta	orë
Velipoja	130	3	4	173	2.9
Dajc	60	3	4	80	1.3

Velipoja Plazh	80	3	4	107	1.8
-----------------------	----	---	---	-----	-----

Distancat e rrugës nga Velipoja dhe nga Dajci në landfillin e Bushatit janë përkatësisht 40 km dhe 32 km.

3.9 Kërkesat për fuqi puntore

Për grumbullimin e mbetjeve është i nevojshëm për cdo kamion një shofer dhe dy puntorë.

Meqënëse pastrimi i parcelave të plazheve private do të jetë një përgjegjësi e subjektit privat që e menaxhon atë plazh, pastrimi dhe mirëmbajtja e rërës (hapsirat publike) në plazhin e Velipojës dhe të Baks – Rjollit do të kryhet me puntorë sezonal. Këta puntorë do të realizojnë grumbullimin e mbeturinave, që mund të jenë të përhapura nëpër rërë, me dorë dhe me qese plastike.

Për grumbullimin e mbetjeve në hapsirat publike të plazhit të Velipojës nevojiten 10 puntorë, ndërsa për plazhet publike në Baks – Rjoll parashikohen edhe 2 puntorë të tjerë. Kjo fuqi punëtore do të punojë me dy orare: gjatë paradites 7 – 10 dhe gjatë pasdites 17 – 20 përgjatë shtatë ditëve të javës.

Gjithashtu për menaxhimin dhe mbajtjen e kushteve higjieno sanitare të banjove publike do të nevojiten të paktën dy puntorë për cdo banjo publike pra gjithësej 8 puntorë.

Stafi i mësipërm do të punësohet me shpenzimet e kompanisë. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse.

3.10 Riciklimi

Bazuar në ligjin nr. 10463 dt. 22.9.2011 për “Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” duhet që cdo bashki kur harton kontratën e shërbimit të pastrimit, ndërmjet aktiviteteve të tjera duhet të përfshijë edhe aktivitetin e riciklimit. Nderkohë bashkia e Shkodrës ka disa vite që po eksperimenton përmes iniciativave të ndryshme pilot grumbullimin e diferencuar të mbetjeve për të arritur minimizimin e sasisë së tyre. Ulja e sasisë së mbeturinave do të thotë një kosto më e ulët për të gjitha fazat e menaxhimit duke filluar që nga grumbullimi, transporti dhe deri tek depozitimi në landfill. Për këto arsye kjo bashki synon që edhe në kontratat e reja për NjA Velipojë dhe Dajc të prezantojë disa aktivitete fillestare për riciklimin.

Rrymat e mbetjeve që do të grumbullohen në mënyrë të diferencuar do të jenë ambalazhet (letra dhe kartoni), materialet plastike (kryesisht shishet plastike dhe PET) si dhe alumini (kanocet e aluminit).

Grumbullimi i diferencuar do të realizohet tek subjektet: bar/restorant, hotele dhe subjekte tregtare (supermarket).

Për prezantimin dhe funksionimin e skemës së riciklimit nevojitet krijimi i një partneriteti ndërmjet bashkisë, kompanisë private të pastrimit dhe subjekteve të ndryshme private që do të marrin pjesë në skemë.

Bashkia duhet të hartojë një kontratë me të gjitha bizneset (baret, hotelet, restorantet dhe supermarketet) të cilat do të jenë pjesë e skemës së riciklimit ku do të përcaktohen qartë protokollet e grumbullimit dhe largimit të kësaj rryme si dhe procedurat e monitorimit dhe sanksionet në rastet e keqfunksionimit. Bizneset që do të marrin pjesë në këtë skemë duhet të caktohen nga bashkia, por gjithësesi duhet të jenë të lokalizuara rreth qendrës së plazhit në Velipojë.

Këto biznese duhet të pajisen nga bashkia me kontenierë të vecantë të dallueshëm dhe duhet të kenë një sistem grumbullimi të vecantë nga kompania private. Kontenierët e riciklimit duhet të jenë 120 litra, të vendosura në ambientet e brendshme të subjekteve private kryesisht për mbledhjen e plastikës. Ndërsa paketimet dhe ambalazhet duhet të mbahen brenda subjekteve private duke u palosur dhe reduktuar në volum. Te gjitha subjektet që do të marrin pjesë në këtë skemë të grumbullimit të diferencuar do të njoftohen për ditën dhe orarin e grumbullimit për të realizuar nxjerrjen e këtyre rrymave në orarin e caktuar përpara derës së subjektit.

Kompania private duhet të sigurojë grumbullimin e këtyre dy rrymave të paktën 1 herë në javë me kamionin 3 ton që përdor për grumbullimin e mbetjeve në rërë. Rrymat e mbetjeve të grumbulluara në këtë mënyrë më tej duhet të transportohen nga kompania drejt pikës së grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme.

Kompania private duhet të ketë një pikë grumbullimi të tillë e cila do të shërbejë për grumbullimin dhe ruajtjen e këtyre materialeve. Kjo pikë mund të ndërtohet në ish vend grumbullimin e mbeturinave në Velipojë.

Në fazën e parë kjo pikë duhet të jetë e pajisur me:

- Konteniere të mëdhenj për grumbullimin e rrymave të sipërpërmendura 5 m³ (dy konteniere një për ambalazhet dhe një për plastikën),
- Një peshore industriale për të peshuar mbetjet që do grumbullohen të ndara dhe
- Një zyrë e vogël e paisur me rregjistrin për rrymat e mbetjeve. Kjo zyrë mund të jetë pika e kontaktit ndërmjet kompanisë dhe firmave të interesuara për blerjen e materialeve të riciklueshme.

Në një fazë të dytë kjo pikë grumbullimi për mbetjet e riciklueshme mund të zgjerohet dhe mund të shërbejë edhe si një platformë tranzitore për mbetjet sidomos gjatë sezonit turistik. Kjo gjë do të ulte kostot e transportit të mbetjeve që grumbullohen në plazhin e Velipojës duke shmangur transportin e dy makinave teknologjike 5 ton, dy herë në ditë drejt lëndfillit të Bushatit dhe për më tepër do të riste mundësinë për të zgjeruar aktivitetin e riciklimit. Sektori informal dhe ai rom mund të jenë aktorët kryesor në zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyrë të organizuar në të ardhmen.

Skenari i parë

Bashkia do të paguaje kompanisë private kostos së transportit për kamionin 3 ton, i cili do të grumbullojë mbetjet nga subjektet private të lokalizuara rreth qendrës së Velipojës (mesatarisht rreth 2 km rrugë) dhe do t'i transportoj

ato deri në pikën e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme në ish vend depozitimin e mbetjeve në Velipojë (mesatarisht 5 km rrugë). Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve të riciklueshme do të kryhet një here në javë. Kompania private mund të përfitojë nga shitja e materialeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar tek subjektet e interesuar. Gjithsesi ajo duhet të raportojë tek bashkia sasitë e grumbulluara në mënyrë të diferencuar. Nga ana tjetër kompania nuk do të paguajë për transportin dhe depozitimin e këtyre materialeve në landfillin e bushatit. Në përfundim të vitit të parë të kontratës nëse firma nuk ka arritur të grumbullojë më shumë se 1% të sasisë të mbetjeve të prodhuara është e detyruar të paguajë mbrapsht 50% të kostos së grumbullimit dhe transportit për kamionin 3 ton që do të kryejë këto aktivitete. Në përfundim të vitit të dytë të kontratës firma duhet të ketë grumbulluar në mënyrë të diferencuar 2% të sasisë së mbetjeve të prodhuara për gjatë këtyre dy viteve, në kundërt duhet të kthejë mbrapsht 50% të cmimit të grumbullimit të këtyre fraksioneve të paguara nga bashkia për gjatë këtyre dy viteve.

Skenari i dytë

Bashkia do të paguajë kompanisë private kostot e transportit për kamionin 3 ton, i cili do të grumbullojë mbetjet në subjektet private që do të realizojnë grumbullimin e diferencuar, i cili do të kryhet serisht një here në javë nëse si në skenarin e parë. Duke qenë se bashkia ka për objektive të saj të grumbullojë në mënyrë të diferencuar 1% të sasisë së përgjithshme të mbetjeve të prodhuara në vit atëherë për gjatë periudhës së veprimit të kësaj kontrate do të reduktojë cmimin njësi që do të paguajë firmës për grumbullimit, transportit dhe asgjësimin e mbetjeve me 1% për gjatë vitit të parë dhe me 1% për gjatë vitit të dytë. Nderkohe që kompania private mund të përfitojë nga shitja e materialeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar tek subjektet e interesuara për këto rryma edhe sikur sasia e grumbulluar vecmas të jetë më e madhe se 1% e sasisë totale të mbetjeve të prodhuara në vit. Gjithsesi ajo duhet të raportojë tek bashkia sasitë e grumbulluara në mënyrë të diferencuar.

3.11 Fushatat e informimit

Në bashkëpunim me bashkinë, kompania që do të ofrojë shërbimin duhet të organizojë një fushatë informimi, për banorët/turistët, bizneset dhe institucionet me objektivat e mëposhtëm:

- pse është e rëndësishme të depozitohen mbetjet në kontenerë dhe jo përreth tyre
- pse është e rëndësishme që mbetjet të depozitohen në një orar të caktuar në kontenerë
- pse është e rëndësishme të mbahet plazhi pastër dhe si duhet të menaxhohen mbetjet personale dhe të depozitohen në kontenerët e plazhit
- pse është e rëndësishme të kryhen aktivitetet e ndarjes së mbeturinave dhe si mund të përfshihen qytetarët dhe bizneset në to
- pse është e nevojshme të paguhet tarifat e shërbimit

4. Llogaritja e kostos së shërbimit për menaxhimin e mbetjeve në NjA Velipojë dhe Dajc

Në paragrafet e mëposhtëm do të synohet llogaritja e kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për NjA Velipojë dhe Dajc si dhe kostot shtesë për sezonin turistik për njësinë administrative Velipojë.

Për të llogaritur koston e plotë të shërbimit është përdorur koncepti i modelit të zhvilluar nga dldp-ja: “Metodat e llogaritjes së kostos dhe tarifës në menaxhimin e mbetjeve të ngurta në nivel njësie të qeverisjes vendore”. Megjithatë për specifikat që ka zona si dhe për disa kufizime të modelit disa llogaritje për zëra të vecantë të kostove janë bërë në excel.

4.1 Llogaritja e kostos për NjA Velipojë dhe Dajc

Në tabelen e mëposhtme jepen të dhënat bazë për dy NjV Velipojë dhe Dajc, të cilat sëbashku prodhojnë 2278 ton mbetje në vit.

Të dhënat bazë

Emri i NJQV	Zona 2	zgjidh/select
Frekuenca e grumbullimit (nr. e mbledhjeve)	2	2 opsione: 2 ose 7
Kategoria (Rurale, Urbane)	Rural	
Popullsia e shërbyer në këtë zonë	8,916	
% e popullsisë që përjashtohen (të regjistruar, por jetojnë jashtë)	0%	
Popullsia shërbyer (merr/konsiderohet për shërbimin)	8,916	
Rrugët (distanca nga Landfill një kah) [km]	35.0	
Rrugët (distanca e përshkuar gjatë grumbullimit për një turn për një kamion) [km]	24.0	
Mbetjet e gjeneruara për eqv. person [kg/ban]	0.70	
Totali i mbetjeve të gjeneruara [t/dit]	6.2	
Totali i mbetjeve të gjeneruara ndërmjet dy grumbullimeve [t] sipas frekuencës	21.8	
Totali i mbetjeve të gjeneruar [t/vit]	2278	

Kamionë**Hipotezat : grumbullimi në të gjithë territorin e NJQV-së, çdo ditë grumbullimi**

Tipi i kamionit [t]	10	
Faktori i mbushjes së kamionit [%]	0.85	
Kapaciteti mbushës i kamionit (85% kapacitet mbushës) [t]	8.5	
<i>Kufiri për numrin e turneve dhe kamionëve që nevojiten (duke marrë në konsideratë faktin e mbushjes së kamionëve plotësisht, për të evituar blerjen e një tjetri) [t]</i>	1.50	
Numri i turneve për kamion në ditë [turne/ditë]	2	1 ose 2 turne
Numri i kamionëve të nevojshëm [total]	1.0	

Kontenierë**Hipoteza : grumbullim në të gjithë territorin, grumbullim çdo ditë**

	JO	Recycle/Riciklim
Kontenitori i mbetjeve (Kazan/Qese) / Collection container (Bins/Sacks)	Kazan	Kazane/Qese - Bins/Sacks
Tipi i kazanit / Bins type	1.1	m3
Pesha e mbetjeve në një kazan [t]	0.117	t
Kazanë/qese ekstra (dëmtim ose nevoja shtesë)	0	add/shto
Numri i kontenitorëve (sipas tipit të zgjedhur - 85% kapacitet mbushës)	187	

Për të realizuar grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të dyja NjA kanë të nevojshme për të përdorur 187 kontenierë 1.1 m³ dhe 1 makinë teknologjike 10 ton. Frekuenca e grumbullimit do të jetë 2 herë në javë, ndërsa kamioni do të punojë me dy turne. Në tabelat e mëposhtme paraqiten të përmbledhura kostot e investimit dhe të mirëmbajtjes dhe operimit.

Kostot operative (grumbullim, transport, mirëmbajtje, personel)

Ditë në punë/VIT (nëse më pak se 2ton/ditë, grumbullimi 2herë/javë)	104
Kostot e karburantit [LEK/l]	140.0

Kostot e mirëmbajtjes

Sigurimi i kamionit + taksat [LEK/kamion/vit]	150,000 Lek	1,079.14 €
Vaj + filtra [LEK/kamion/vit]	90,000 Lek	647.48 €
Goma [LEK/kamion/vit]	160,000 Lek	1,151.08 €
Mirëmbajtja mekanike [LEK/kamion/vit]	200,000 Lek	1,438.85 €
Parkim [LEK/kamion/vit]	50,000 Lek	359.71 €
Kostot totale të mirëmbajtjes [LEK/vit]	650,000 Lek	4,676.26 €

Kostot e grumbullimit dhe të transportit**Kostot e grumbullimit**

Koha për të ngarkuar një kamion në herë - koha e grumbullimit [h]	4.0	
Koha totale për grumbullim (nr. kamionëve * kohë/kamion * nr. i turneve) [h/ditë]	8	
Koha për të shkarkuar në "landfill" [h]	0.3	
Proporcioni i kohës totale për grumbullim [%]	73%	
Karburanti i konsumuar gjatë grumbullimit [L/vit]	43.0	
Karburant total i konsumuar për grumbullim [L/vit]	4,472.0	
Kostot totale për grumbullim [vit]	626,080 Lek	4,504.17 €

Kostot e transportit

Shpejtësia e lëvizjes [km/h]	60.0	
Koha e transportimit për në "landfill" [h]	1.2	
Koha totale e harxhuar për transportim (një ditë/të gjithë kamionët) [hr/d]	2.9	
Proporcioni i kohës totale për transport [%]	27%	
Totali i km për transport për ditë, të gjithë kamionat [km/d]	140	
Karburan i konsumuar gjatë transportit [L/d]	63.0	
Totali i karburantit të konsumuar për transport [L/vit]	6552	
Kostot totale për transport [vit]	917,280 Lek	6,599.14 €

Grumbullim dhe transport, nëntotal kosto

Koha në shkarkim në "landfill" (dist.*2/shpejtësi+shkarkim 0,30 h) [h]	1.5	
Koha totale e shpenzuar nga një kamion për të përfunduar në një turn [h/turn]	5.5	
Koha totale e harxhuar për grumbullim dhe depozitim (një ditë/të gjithë kamionët) [hr/d]	10.9	
Totali i karburantit të konsumuar [L/ditë]	106.0	
Totali i karburantit të konsumuar [L/vit]	11,024.0	
Totali i kostos për karburant për grumbullim dhe transport [LEK/vit]	1,543,360 Lek	11,103.31 €

Kostot e personelit

Koha maksimale e punës [h/ditë]	8.0
Ditët maksimale të punës në javë [d/javë]	7.0
Orër maksimale të punës në javë [h/javë]	40
Mirëmbajtja [% e kohës së punës]	7.3%
Pushimet [% e kohës së punës]	7.7%

Shoferi**Përlogaritja sipas nevojës ditore:**

Numri i shoferave bazuar në nevojën ditore (duke marrë në konsideratë kufizimet sipas turneve = nuk mund të ndërrohen shoferat në mes të turnit)	2	
--	---	--

Përlogaritja sipas nevojës javore:

Working hours per week / driver, including maintenance [h/w]	10.9	
Does it comply the law, considering max working hours and holidays? (if no, more drivers must be considered)	PO	
Total drivers needed based on weekly needs (considering max. working time, maintenance and holidays)	2	
Remaining time for other tasks per week / driver [h/w]	29.06	

Paga mujore e shoferit [LEK/muaj]	25000	
Taksat [%]	48%	
Paga e bruto e shoferave [LEK/vit]	888,000 Lek	6,388.49 €

Punonjës/operatorë

Numri i punonjësve për ekip (1 shofer, x punonjës)	2	
Numri total i punonjësve	4	
Punonjësit shoqërojnë kamionin në "landfill" (po/jo)	no	
Working hours per week / worker (incl. maintenance) [h/w]	7.98	
Remaining time for other tasks per week / worker [h/w]	31.98	
Paga mujore e punonjësit [LEK/muaj]	19000	
Taksat [%]	48%	
Pga bruto e punonjësve [LEK/vit]	1,349,760 Lek	9,710.50 €

Kostot nëtotale për personelin

Kostot për personelin [LEK/vit]	982 Lek	7.07 €
Kostot për personelin [LEK/banor/vit]	251 Lek	1.81 €
Kostot totale për personelin [LEK/vit]	2,237,760 Lek	16,098.99 €

Kostot totale (Mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel)

Kostot operacionale për ton [LEK/t]	1,945 Lek	13.99 €
Kostot operacionale për banor/vit [LEK/ban./vit]	497 Lek	3.58 €
Kostot nëtotale operacionale (Mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel) [LEK/vit]	4,431,120 Lek	31,878.56 €

Investimet kapitale**Kamionë**

Kosto e një kamioni [LEK]	5,977,000 Lek	43,000.00 €
Totali i kostove për kamionë (urbane e madhe + 1 rezervë) [LEK]	5,977,000 Lek	43,000.00 €

Kontenitorët (Kazanë ose Qese)

Kosto e një kontenitori (tipi i përzgjedhur) [LEK]	35,000 Lek	251.80 €
Totali i kostos për kontenitor [LEK]	6,541,579 Lek	47,061.72 €
Kosto nëtotale për investime [LEK]	12,518,579 Lek	90,061.72 €

Kostot e depozitimit (Landfill)

Tarifa e depozitimit [LEK/ton]	386 Lek	2.78 €
Kostot totale për depozitim (ton total * kostot për ton) në ditë [LEK/d]	2,409 Lek	17.33 €
Kostot totale për depozitim [LEK/ban./vit]	99 Lek	0.71 €
Kostot totale për depozitim (ton total * kostot për ton) [LEK/vit]	879,323 Lek	6,326.06 €

Kostot e amortizimit**Kamionë**

Amortizimi i kamionit në vite [vit]	8%	
Amortizimi i kamionëve [LEK/vit]	478,160 Lek	3,440.00 €

Kazanë

Amortizimi i kazanit në vite [vit]	10%	
Amortizimi i kazanëve [LEK/vit]	654,158 Lek	4,706.17 €

Kosto nëntotale për amortizimin [LEK]

Kosto totale amortizimi [LEK/vit]	1,132,318 Lek	8,146.17 €
Kosto totale amortizimi [LEK/ton]	497 Lek	3.58 €
Kosto totale amortizimi [LEK/banor/vit]	127 Lek	0.91 €

Kostot totale**Kostot totale operacionale (Mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel, depozitim, amortizim)**

Kosto totale operacionale [LEK/vit]	6,442,761 Lek	46,350.80 €
-------------------------------------	---------------	-------------

Kostot totale operacionale (Mirëmbajtje, grumbullim, transport, personel, depozitim, amortizim + kostot administrative dhe fitim neto)

Kostot administrative [% e kostove totale]	9%	
Kostot administrative për grumbullimin e taksave [% e kostove totale]	0%	
Kostot administrative për fushatat e ndërgjegjësimit publik [% e kostove totale]	0%	
Kostot totale administrative [LEK/vit]	579,848Lek	4,171.57 €
Të ardhurat neto [% e kostove totale]	4%	
Totali i të ardhurave neto [LEK/vit]	257,710 Lek	1,854.03 €
Kostot totale operacionale + administrative [LEK/vit]	7,280,319 Lek	52,376.40 €
Kostot totale për ton mbetje (cikël i plotë) [LEK/t]	3,196 Lek	22.99 €
Kostot totale për banor mbetje në vit (cikël i plotë) [LEK/ban./vit]	817 Lek	5.87 €

Investimet

Kostot totale për investime	12,518,579 Lek	90,061.72 €
------------------------------------	-----------------------	--------------------

Për investimet në infrastrukturë është parashikuar që kosto e amortizimit të jetë 15% e vlerës së mbetur të investimit në cdo vit. Kohëzgjatja e vlerës së investimit është parashikuar 10 vjet, ndaj norma e amortizimit është llogaritur mesatarisht si 8% e vlerës së investimit për makinat teknologjike dhe 10% për kontenierët.

Në tabenat e mëposhtme paraqiten kostot njësi për banorë dhe për ton në vit.

Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor		
<i>Grumbullim</i>	79 Lek	0.57 €
<i>Transport</i>	116 Lek	0.84 €
<i>Mirëmbajtje</i>	82 Lek	0.59 €
<i>Personel</i>	284 Lek	2.04 €
<i>Amortizim</i>	144 Lek	1.03 €
<i>Depozitim</i>	111 Lek	0.80 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto	817 Lek	5.87 €

Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit		
<i>Grumbullim</i>	311 Lek	2.23 €
<i>Transport</i>	455 Lek	3.27 €
<i>Mirëmbajtje</i>	322 Lek	2.32 €
<i>Personel</i>	1,110 Lek	7.99 €
<i>Amortizim</i>	562 Lek	4.04 €
<i>Depozitim</i>	436 Lek	3.14 €
Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto	3,196 Lek	22.99 €

4.2 Llogaritja e kostos për sezonin turistik në Velipojë

Kosto e investimeve për infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve

Investimet në infrastrukturë	
Kostot e një kamioni 5t [LEK]	3,588,000 Lek
Totali i koston për kamionë [LEK]	8,970,000 Lek
Kosto e një kontenitori (tipi i përzgjedhur) [LEK]	35,000 Lek
Totali i koston për kontenierë [LEK]	2,744,318 Lek
Kosto per bazamentet e kontenierëve	8,000 Lek
Totali i koston për bazamente [LEK]	209,091 Lek
Kosto nëntotale për investime [LEK]	11,923,409 Lek
Kosto e menaxhimit te mbetjeve per banore	317.96 Lek
Kosto e menaxhimit te mbetjeve per ton ne vit	6,359.15 Lek

Kosto operacionale e menaxhimit të mbetjeve

Kosto e amortizimit	
Amortizimi i kamionit në vite [vit]	8.00%
Amortizimi i kamionëve [LEK/vit]	717,600 Lek
Amortizimi i kazanit në vite [vit]	10.00%
Amortizimi i kazanëve [LEK/vit]	274,432 Lek
Amortizimi për bazamentet e kontenierëve [vit]	2.00%
Amortizimi i bazamenteve në vite [lek/vit]	4,182 Lek
Kosto nëntotale për amortizimin [LEK/vit]	996,214 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve per banore	26.57 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve per ton ne vit	531.31 Lek

Kosto e mirëmbajtjes	
Sigurimi i kamionit + taksat [LEK/kamion/vit]	100,000 Lek
Vaj + filtra [LEK/kamion/vit]	75,000 Lek
Goma [LEK/kamion/vit]	160,000 Lek
Mirëmbajtja mekanike [LEK/kamion/vit]	200,000 Lek
Parkim [LEK/kamion/vit]	50,000 Lek
Kosto nëntotale për mirëmbajtjen [LEK/vit]	1,462,500 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve per banore	39.00 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve per ton ne vit	780.00 Lek

Kosto e grumbullimit për PGM	
Koha për të ngarkuar një kamion [h]	3
Koha për të shkarkuar në "landfill" [h]	0.3
Karburanti i konsumuar gjatë grumbullimit [L/dit]	19.8
Ditë pune në vit	100
Karburant total i konsumuar për grumbullim [L/vit]	1980
Kosto e karburantit [lek/l]	140
Kosto nëntotale për grumbullimin e PGM [LEK/vit]	693,000 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve per banore	18.48 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve per ton ne vit	369.60 Lek

Kosto e transportit të mbeturinave

Shpejtësia e lëvizjes [km/h]	60
Distanca nga landfilli	45
Koha e transportimit për në "landfill" [h]	1.50
Nr i turneve	2
Nr i kamioneve	2
Koha totale e harxhuar për transportim (një ditë/të gjithë kamionët) [hr/d]	6.00
Totali i km për transport për ditë, të gjithë kamionat [km/d]	360
Karburan i konsumuar gjatë transportit [L/d]	144
Totali i karburantit të konsumuar për transport [L/vit]	14400
Kosto nëntotale për transportin e mbeturinave [LEK/vit]	2,016,000 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve per banore	53.76 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve per ton ne vit	1,075.20 Lek

Kosto e grumbullimit dhe transportit të rrymave të riciklueshme

Km e pershkuara per grumbullim	2
Km e pershkuara per transport	5
konsumi i karburantit	3
Ditë pune në vit	100
Kosto e karburantit	140 Lek
Kosto nëntotale për riciklimin [LEK/vit]	588,000 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve per banore	15.68 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve per ton ne vit	313.60 Lek

Kosto e personelit

Paga mujore e shoferit [LEK/muaj]	25,000
Taksat [%]	48%
Nr i shoferave	4
Paga e bruto e shoferave [LEK/vit]	488,400 Lek
Paga mujore e punonjësit [LEK/muaj]	19,000
Taksat [%]	48%
Nr i punonjesve	20
Paga bruto e punonjësve [LEK/vit]	1,855,920 Lek
Kosto nëntotale për personelin [LEK/vit]	2,344,320 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve per banore	62.52 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve per ton ne vit	1,250.30 Lek

Kosto administrative e menaxhimit të mbetjeve

Kosto e grumbullimit për PGM	
Kosto totale operacionale [LEK/vit]	8,100,034 Lek
Kosto administrative [% e kostove totale]	9%
Kosto totale administrative [LEK/vit]	729,003 Lek
Të ardhurat neto [% e kostove totale]	4%
Totali i të ardhurave neto [LEK/vit]	324,001 Lek
Kosto nëntotale administrative [LEK/vit]	1,053,004 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve për banorë	28.08 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve për ton në vit	561.60 Lek

Kostot totale operacionale + administrative [LEK/vit]	9,153,038 Lek
--	----------------------

Kosto e depozitimit për menaxhimit të mbetjeve

Kosto e depozitimit të mbetjeve në lëndfill	
Tarifa e depozitimit [LEK/ton]	386 Lek
Kostot totale për depozitim (ton total * kostot për ton) në ditë [LEK/d]	7,238 Lek
Kostot totale për depozitim (ton total * kostot për ton) [LEK/vit]	723,750 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve për banorë	19.30 Lek
Kosto e menaxhimit të mbetjeve për ton në vit	386.00 Lek

Atehere në mënyrë të përbledhur në tabelën e mëposhtme paraqiten kostot operative për bashkinë për të kryer të gjitha aktivitetet e pastrimit për njësitë administrative Velipojë dhe Dajc.

Kostot e pastrimit për njësitë administrative Velipojë dhe Dajc	Skenari 1 me riciklim	Skenari 2 me riciklim
Kosto operacionale përgjate gjithë vitit	7,947,644	7,947,644
Kosto operacionale shtese për sezonin turistik	9,876,788	9,778,020
Totali	17,824,432	17,725,846

5. Penalitetet

5.1 Mos mbledhja e mbeturinave apo lënia e disa pikave të grumbullimit të pa mbledhura

- Duhet që kompania të grumbullojë të gjitha pikat e përkohshme të grumbullimit sipas frekuencës së kërkuar dhe të përcaktuar në ToR. Supervizori i bashkisë pasi të bëjë monitorimin duhet të raportojë tek

drejtori i shërbimeve në bashki, në qoftë se grumbullimi dhe largimi i mbeturinave nuk është bërë në përputhje me skedulen e dakortësuar dhe firmosur si nga bashkia ashtu edhe nga kompania private.

- Në raportin e supervisorit duhet të përmendet ora e supervizimit dhe të gjitha parregullsitë në zbatimin e procedurave të grumbullimit duke evidentuar dhe numrin e kontenierëve të pa grumbulluar për atë turn.
- Në qoftë se numri i kontenierëve të pa grumbulluar brenda javës është 2% e sasisë totale të kontenierëve (afërsisht 6 kontenierë) atëherë kompania do të gjobitet me 100 fishin e kostos së grumbullimit dhe transportit të një kontenieri për çdo kontenier të pa grumbulluar.

5.2 Riparimi i kontenierëve të dëmtuar dhe zëvendësimi i tyre në pikat e përkoheshme të grumbullimit

- Kontenierët e dëmtuar duhet të zëvendësohen me kontenierë të rregullt. Është në interesin e kompanisë që të mos ketë kontenierë të dëmtuar, gjë e cila do të rriste kostot e grumbullimit.
- Është detyra e supervisorëve të bashkisë të identifikojnë dhe të raportojnë tek kompania numrin e kontenierëve të dëmtuar të cilët duhet të zëvendësohen dhe të riparohen. Nuk duhet të lejohet që numri i kontenierëve të dëmtuar të jetë më shumë se 3% e totalit të numrit të kontenierëve (8 copë) përgjatë një jave raportim.
- Nëse kompania nuk i tërheq për t'i riparuar dhe nuk i zëvendëson këta kontenierë të dëmtuar me kontenierë të tjerë brenda një jave që nga momenti kur ata raportohen si të dëmtuar atëherë ajo do të penalizohet me një reduktim prej 10% të cmimit të grumbullimit të një kontenieri për të gjithë kontenierët e dëmtuar për të gjithë periudhën që ata nuk janë riparuar.

5.3 Mos larja dhe mos disinfektimi i kontenierëve

- Duhet që kompania të garantojë larjen dhe dizinfektimin e të gjithë kontenierëve sipas specifikimeve të kësaj kontrate.
- Supervisorin i bashkisë pasi të bëjë monitorimin duhet të raportojë tek drejtori i shërbimeve në bashki, në qoftë se shërbimi i larjes dhe disinfektimit nuk është bërë në përputhje me skedulen e dakortësuar dhe firmosur si nga bashkia ashtu edhe nga kompania private.
- Në raportin e supervisorit duhet të përmendet dita dhe ora e supervizimit si dhe numri i pikave të përkohshme të grumbullimit apo sasia e kontenierëve të pa larë apo disinfektuar.
- Në qoftë se numri i kontenierëve të pa pastruar brenda muajt është 3% e sasisë totale të kontenierëve (afërsisht 8 kontenierë) atëherë kompania do të gjobitet me 100 fishin e kostos së larjes dhe disinfektimit të një kontenieri për çdo kontenier të pa larë dhe të pa disinfektuar.

5.4 Hedhja e mbeturinave në vende të tjera, jo në ato të përcaktuara nga bashkia

- Kompania duhet të depozitojë mbetjet në lëndfillin e Bushatit. Ajo duhet të raportojë sasisë ditore dhe mujore të rrugëve dhe sasisë së mbeturinave të depozituara në lëndfillin e Bushatit.
- Është detyra e supervisorëve të bashkisë të kontrollojnë dhe të raportojnë në lidhje me këtë aktivitet të kompanisë që ofron këtë shërbim. Në rast se identifikohen shkarkime të kamioneve të kompanisë në pika të paautorizuara nga Bashkia, atëherë kompania do të penalizohet me një gjobë prej 1.000.000 lek. Gjithashtu ajo duhet që të grumbulloj, ngarkoj, pastroj dhe të transportoj të gjitha mbetjet e depozituara në mënyrë të paregullt drejt lëndfillit të Bushatit me kostot e veta.

5.5 Mos fshirja e rrugëve

- Kompania duhet të fshijë të gjitha rrugët e përcaktuara në kontratë sipas frekuencave dhe orareve të dakortësuara në kontratë.
- Nëse ky shërbim nuk realizohet qoftë sipas frekuencës së përcaktuar, orarit apo cilësisë së dëshiruar në ndonjë prej rrugëve të përcaktuara në kontratë, atëherë kompania do të penalizohet me një reduktim prej 10% të cmimit mujor për fshirjen e rrugëve.
- Në rast se do të evidentohen hedhje të mbeturinave që vijnë nga fshirja (llumi apo sasi dherash, gjethe apo mbetje nga kopshtet) të depozituara në kunetat e kullimit atëherë kompania do të gjobet me një shumë prej 50.000 lekësh si dhe do të detyrohet të bëjë cbllokimin e tyre dhe depozitim të këtyre mbetjeve në kontenerët më të afërt.

5.6 Mungesa e raportimit ose realizimi i tij në mënyrë të gabuar

- Kompania është e detyruar të paraqesë raporte të detajuara mujore me të dhëna statistikore në lidhje me të gjitha operacionet që ajo realizon si obligim i kësaj kontrate. Kështu kompania duhet të raportojë në lidhje me grumbullimin dhe menaxhimin e kontenierëve, grumbullimin e mbeturinave nga zona e plazhit, grumbullimin e diferencuar të rrymave të vecanta, larjen dhe disinfektimin e kontenierëve, transportin e mbeturinave me të gjitha mjetet e transportit, depozitim të mbeturinave në lëndfillin e Bushatit si dhe fshirjen e rrugëve.
- Të gjitha raportet duhet të përputhen me punën dhe volumet e kryera në realitet nga kompania.
- Raporti duhet të hartohet brenda dy javëve të para të muajt pasardhës dhe duhet t'i dorëzohet supervisorit të bashkisë.
- Supervisorit të bashkisë duhet të bëjë kontrollin e raportit me të dhënat që ai ka nga situacionet ditore si dhe me të dhënat e marra nga lëndfilli i Bushatit. Për çdo raport të munguar apo të vonuar apo me të dhëna jo të sakta do të shoqërohet me një gjobë e cila është një reduktim prej 3% të cmimit mujor që duhet t'i paguhet kompanisë.